

Kontratat Nacionale e Punës

150 franga më shumë në muaj

2

Votimet federale më 30 nëntorë

Mjaft më politkave ksenofobe!

3

Të drejtat e njeriut në botën e punës

A funksionojnë sindikatat në Kosovë?!

4

Nr. 5 | shtator 2014 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Nxënësit shegertë

Më shumë mbrojtje për shegertët!

Në fund të qershorit u prezantua raporti i ri i shegertëve. Anketa tregon: shumë shegertë bëjnë orë të tepërta ilegale dhe mungesa e pjesërishme e përkujdesit profesional. Gjithashtu në fund të qershorit rinia sindikaliste ka iniciuar një petition, i cili kërkon që nxënësit shegertë të kenë mbrojtje më të mirë.

Raporti mbi nxënësit shegertë është i dyti i Unia-s, i cili grumbullon të dhëna mbi nxënësit shegertë dhe i analizon ato. Anketa e parë është zhvilluar në vitin 2007/2008 në kuadër të kampanjës «Nxënësit shegertë kanë vlerë ari». Raporti i shegertëve u shërben prindërve dhe nxënësve shegertë për tu informuar mbi perceptimet mbi shegertët dhe mbi kushtet e tyre të arsimimit profesional.

Kujdes orët e tepërta

Orët e tepërta, pra puna, e cila tejkalon atë të kontraktuar, mund të kërkohej nga shegertët. Mirëpo orari i punës bashkë me orët e tepërta në një ditë nuk guxojnë të jenë më tepër se 9 orë. Po që se nxënësit shegertë duhet të bëjnë orë shtesë, në përgjithësi atyre u takon një rritje page prej së paku 25%, apo ekziston edhe mundësia që këto të kompensohen me kohë të lirë. Edhe pse shumica shfrytëzojnë këtë të fundit, rreth një e katërta e nxënësve shegertë as paguhen shtesë e as u kompensohet koha e lirë.

Kualiteti i arsimimit shembullor

Arsimuesit profesional janë të obliguar, të garantojnë kualitetin e arsimimit profesional. Kantonet duhet të kontrollojnë kualitetin e arsimimit si dhe përshtatshmërinë e vendeve e ndërmarrjeve ku aftësohen shegertët. Kualiteti i arsimimit në anketën e Unia-s nga nxënësit shegertë vlerësohet pozitivisht.

Përkujdesa profesionale shpesh e pa garantuar

Shegertët nxënës gjatë arsimimit profesional duhet të mësojnë nga të punësuarit tjerë si dhe nga arsimuesit profesional. Pos tjerash ata nuk duhet lenë vet në situatat dhe detyrat e reja apo të tej ngarkohen si dhe duhet



Shegertët nuk gëzojnë mbrojtje të mjaftueshme në vendin e punës

të kihet parasysh siguria e tyre. Andaj është qendrore që shegertët nxënës gjatë tërë kohës së arsimimit profesional duhet të jenë nën përkujdesje në vendin e punës. Anketa tregon: këto kushte nuk plotësohen gjithmonë, pasi që rreth gjysma e tyre shumë herë në muaj dhe javë lihen pa përkujdesje.

Ka nevojë për më shumë mbrojtje!

Rinia sindikaliste ka nisur një petition, në të cilin kërkohej më shumë mbrojtje për nxënësit shegertë. Kështu ata reagojnë kundër shkeljeve në rritje nga ana e punëdhënësve karshi rregullave ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shegertëve nxënës. Hulumtimet tregojnë se janë shpeshuar posaçërisht shkeljet përkitazi me orarin e punës. Pos kësaj për çdo vit rreth 25 000 shegertët nxënës janë viktimë të aksidenteve profesionale. Kështu aksidentohet secili/a shegert/e i/e tetë gjatë arsimimit profesional.

Nënshkruani petitionin!

Shumë parregullsi dhe jo pak aksidente do të mund të mënjanohej, nëse zyrtarët kujdesen për një mbikëqyrje konsekuente të aftësimin profesional të nxënësve shegertë. Andaj përmes petitionit kërkohej që për çdo ndërmarrje arsimore të bëhet së paku një kontroll e pavarur në vit, kriteret më të rrepta për

dhënie e lejes ndërmarrjeve arsimore dhe dhënie fund kursimeve në kurriz të të rinjve. Kantonet duhet më në fund të lënë në shërbim më shumë resurse për veprimtarinë kontrolluese. Shëndeti dhe siguria e të rinjve që janë në arsim profesional nuk duhen aq lehtë të vihen në lojë.

✉ Aurora García



Nënshkruani petitionin e rinisë sindikaliste, i cili kërkon më shumë kontrollë ndërmarrjeve arsimore dhe më shumë mbrojtje

për të rinjtë që janë duke vijuar arsimimin profesional! Nënshkrimi online gjendet në vegën vijuese:

www.gewerkschaftsjugend.ch/lehrlingspetition (gjermanisht), apo www.jeunesse-syndicale.ch/petition-apprenti-e-s/ (frëngjisht).

Editorial



Në fillim të qershorit u zbulua një rast i madh i dumpingut në paga: 28 punëtorë fasadash polak nga një nën-ndërmarrje polake në vend se të merr 35 frangat korrekte në orë, mjerisht morën vetëm 12 franga neto në orë, dhe kjo zgjati një vit të tërë, pa pagën e 13-të mujore dhe pa shtojcën javore. (shih lajmet e shkurtra në këtë numër).

Punonjësit polak janë urdhëruar nga shefat e tyre, që inspektorëve të punës tu japin të dhëna të rrejshme, pra pagën të cilën do të duhej marrë. Mirëpo, edhe nëse punëtorët do të thonë të vërtetën: Përkthyesi i tyre ishte njëkohësisht edhe mbikëqyrësi i tyre, kështu ata i kishin duart e lidhura.

Ky rast nuk ve në pah vetëm rëndësinë e kontrolleve, porse edhe domosdoshmërinë që me rastin e kontrolleve të punës të ketë edhe përkthyes neutral. Pasi nëse përkthyesi është edhe shef atëherë nuk do të është e mundur të zbulohen parregullsitë nëpër kantieret pune. Rasti i «Roche»-es ka treguar edhe diçka tjetër:

Një grup i këtyre punëtorëve fasadash vendosi që për rastin e tyre të informojë sindikatën Unia, pasi që nuk mund ta duronin edhe më tej gënjeshttrat me rastin e kontrolleve. Vendimtar për një hap të tillë të tyre ishte besimi që ata kishin tek sekretarët sindikal, të cilët ishin rregullisht në kantier. Prezenca e sindikatës, puna e tyre konsekuente nëpër kantiere, mbledhjet e rregullta mes punëmarrësve dhe sekretarëve sindikal, të cilët flisnin guhen e tyre, apo edhe vijën nga i njëjti vend sikur ata, janë parakushtet për të ndërtuar besimin e qëndrueshëm. Kjo punë duhet zhvilluar më tej. Krahas kësaj duhet që edhe zyrtarët të fuqizojnë kontrollin dhe inspektorët e punës të pajisen me përkthyes.

Adam Rogalewski
Sekretar sindikal për migracion

News

Ankesa e Unia-s kundër punës së dielave

Qe pesë vjet Kantoni Graubünden i lejon «Outlet Center» në Landquart të punojë ilegalisht të dielave dhe tani së fundi përpiqet të mos respekton edhe vendimin e gjyqit federal. Sindikata Unia do të kundërshtoj edhe më tej me vendosmëri këtë mospërfillje të ligjit të punës dhe do të bëjë ankesë kundër Entit Kantonal për Punë (Kiga) të këtij Kantoni. Ky Ent me ligj është i obliguar të kujdeset për zbatimin e vendimeve gjyqësore federale.

Iniciativa për dumpingun e pagave në Cyrih

Grumbullimi i nënshkrimeve për iniciativën mbi dumpingun në paga u arrit vetëm për 33 orë. Nënshkrimet janë vërtetuar dhe iniciativa tanimë është zyrtare. Qe me të vërtetë ka nevojë për një instrument të qëndrueshëm kundër dumpingut në paga, tregon pas rastit në kantieret e stacionit kryesor në Cyrih dhe ZARA gjithashtu edhe rasti rekord i dumpingut në paga i Bazeli, apo rasti keqpërdorues i kohëve të fundit në Hunzikerareal të Cyrihut. Unia pret nga kryesuesi përgjigje i qeverisë së Kantonit Cyrih, Ernst Stocker, që ai përmes procedurës së përsheptuar të mundëson votimin sam ë shpejt që është e mundur.

Marrëveshje në rastin e dumpingut në Roche



Në fillim të qershorit u bë e njohur, se në «Roche Turm Bau 1» erdhi tek dumpingu masiv në paga. Tek pas një jave këmbënguljeje kokëfortë Unia arriti një zgjidhje me Roche. Në hapin e parë të vogël të prekurit do të marrin nga Roche kompensimin e pagesës së parë nga gjithsejtë gjysmë milioni franga si dhe kontratat e reja korrekte të punës nga firma «Josef Gartner».

Mirëpo me këtë nuk është zgjidhur problemi tërësisht. Roche dhe Gartner tani duhet të gjithë punëtorëve tua llogarisin pagat që atyre u takojnë dhe tua paguajnë ato sa më parë.

FAR për moler dhe gipsier?

Mbledhja e delegatëve të shoqatës zvicerane të gipsierëve de molerëve (SMVG) në fund të qershorit ka dhënë dritën e gjelbër për bisedimet për një model mbi pensionimin e mëhershëm. Sindikata Unia përsërit këto vendim. Tani mbetet që ky model sam ë parë që të jetë e mundur të vendoset dhe të realizohet, e i cili të punësuarve në këta sektorë u mundëson tërheqjen e parakohshme nga veprimtaria e kësaj pune së vështirë.

Kontrata Nationale e Punës (LMV)

150 franga më shumë pagë për punëtorët e ndërtimit!

Sektorit të ndërtimit ka vite që i shkojnë punët për mrekulli, pasi libri i kontraktimit të punëve është përplot. Por punëtorët e ndërtimit nga kjo gati asgjë nuk janë duke përfutur. Andaj në bisedimet e sivjetme punëtorët e ndërtimit kërkojnë një rritje page prej 150 frangave në muaj. Një peticion do të dhënë theks mbështetës kësaj kërkesë.

Ekonomia e ndërtimit ka punët shumë mirë. Është duke u ndërtuar si kurrë më parë, pasi volumi i ndërtimeve në Zvicër në 10 vitet e fundit është rritur për 40%. Në vitin 2013 fitimet ishin aq të mëdha, sa që flitet për një vit rekord. Ndërsa këtë vit fitimet do të jenë po aq të larta sa vitin e kaluar.

S'ka rritje pagash për punëtorët e ndërtimit

Pra edhe pse industria e ndërtimit në Zvicër i ka punët shkëlqyeshëm, kjo nuk vlen për pagat e punëtorëve të ndërtimit. Rroga mesatare e paguar mes viteve 2007–2013 u rrit mjerisht vetëm për 4.92%. Kjo ngritje e ulët mbetet në krahasim me ngritjen e prodhimit (+9% për periudhën e njëjtë kohore), por është edhe më e ulët se sa ngritja mesatare e pagave në Zvicër (+5.69% për periudhën e njëjtë kohore)

Më në fund një ngritje korrekte e pagave!

Në kuvendin e fundit vendor, të «parlamentit» të punëtorëve të ndërtimit në Unia, më datën 20 gusht rreth 500 punonjës të pranishëm të ndërtimit kanë vendosë, që të kërkojnë ngritjen për këtë vit ngritja

timtarisë në Unia, më datën 20 gusht rreth 500 punonjës të pranishëm të ndërtimit kanë vendosë, që të kërkojnë ngritjen për këtë vit ngritja

të pagës prej 150 frangave në muaj. Punëtorët e ndërtimit meritojnë fitimin e pjesës së tyre të suksesit, pasi pa ata nuk do të ishte i mundur sukcesi i industrisë ndërtimore të Zvicrës. Pos kësaj ata jo vetëm se kryejnë punë të vështirë dhe vejnë shëndetin e tyre në rrezik, por ata janë që dinë se çka domethënë pagesa gjithmonë në rritje e qirave të banesave dhe primive shëndetësore.

Nënshkruani peticionin për rritjen e pagave!

Para se vitin e ardhshëm të negocihet ripërtëritja e Kontratës Nationale të Punës (LMV) për sektorin kryesor të ndërtimit, duhet që këtë vjeshtë të arrihet një ngritje e mirë e pagave. Ne e kemi pa në vitin e kaluar: Punëmarrësve të ndërtimit nuk do tu dhurohet asgjë. Secili përmirësim – qoftë pensionimi i parakohshëm, pushimet apo shtojcat – arrihen vetëm atëherë, kur punëtorët dhe sindikatat bashkë të kenë luftuar për diç të tillë. Andaj të luftojmë bashkërisht për paga më të mira! Hapi i parë i kësaj lufte të përbashkët është mbledhja e nënshkrimeve për peticionin që kërkon 150 franga më shumë në muaj dhe ndërmarrje të masave ndikuese kundër dumpingut në paga.

Peticioni do të shpërndahet nëpër kantieri pune, andaj dhe janë të ftuar të gjithë punëtorët e ndërtimit të nënshkruajnë peticionin. Bashkë jemi më të fortë!

Aurora Garcia



Seanca e migrantëve, FIMM Zvicër

Seanca e migrantëve: hapat fillestar janë bërë, duhet të vijojmë më tej!

FIMM (Forumi për integrimin e migrantëve e migrantëve) Zvicër, si organizatë çati e shoqatave të shumta të huaja në Zvicër, dëshiron që në vitin 2 vje analoge sikur që është seanca shumëvjeçare rinore – një sesion parlamentar për migrantet/ët. Seksionet regjionale do të duhej të zhvilloheshin në rrethet e mëdha të Zvicrës, ndërsa në nivel kombëtar parashihet një seancë parlamentare federale.

Përfjetimi nga afër i kulturës politike zvicerane

FIMM- Zvicër përmes nismës të këtij projekti afatgjatë, ka për qëllim tua sqaron një numri të madh të prekurish mekanizmat e ndërlikuar, kulturën dhe organizimin e jetës shtetërore zvicerane dhe të nxisë par-



Diskutimet vijojnë edhe gjatë pauzave



Përgaditja e koordinatorëve regjional

ticipimin politik të tyre. Integrimi përmes participimit politik të migrantëve pa të drejtë vote dhe zgjedhje është një nga preokupimet kryesore dhe përqendrim i veprimtarisë së FIMM-Zvicër. Migrantet/ët në kuadër të seancës parlamentare do të ballafaqohen me temat politike në Zvicër dhe nëpër Kantone dhe njëkohësisht do të mund njihen edhe me demokracinë e drejtpërdrejtë të

Zvicrës. Seanca parlamentare do tu mundëson migrantëve/ëve të formulojnë kërkesat e tyre, edhe për tu perceptuar ato më mirë nga politika zvicerane. Kështu ata, duke përjetuar për së afërmi kulturën politike, mund të motivohen edhe për angazhim në shoqëri. Ata do të mund të kontribuojnë në shoqëri dhe të përjetojnë edhe vetë një etapë të rëndësishme të procesit integruar.

Një qëllim prioritar dhe parakusht i rëndësishëm për suksesin e projektit është pjesëmarrja sa më e madhe e mundshme e migrantëve nga sa më shumë grupe e rrethe.

Duam pjesëmarrje të madhe

Pasi të 10 koordinatorët/ët në përgjithësi kanë kryer punën e tyre, tanimë është evoluar pjesa e parë e projektit. Janë zhvilluar numër mbresëlënës i aktivitetëve. Përmes shumë manifestimeve nëpër të gjitha regjionet e Zvicrës u adresuan rreth 300 persona kyç nga organizata të ndryshme migrantësh. Një numër i madh i personave të kontaktuar ka treguar interes të angazhohen në këtë proces. Etapat tjera të projektit do të planifikohen bashkë me pjesëmarrësit.

Multiplikatorët krijojnë rrjetet

Projekti ka startuar në verë të vitit 2013, përmes takimeve zhvillimore me grupe të interesuara, shoqata dhe organizata të migrantëve. Janë përzgjedhur 10 koordinator/e nga Zvicra gjermane, franceze dhe italiane, të cilët janë vu në kërkim të multiplikatorëve nëpër regjionet e tyre, për të kontribuar në qëllimin e mbajtjes së seancat regjionale të migrantëve.



Koordinatorët dhe multiplikatorët vijnë nga të gjitha regjionet e Zvicrës

Heidi Mück përgjegjëse për komunikim dhe punë politike në FIMM-Zvicër

Votimet federale, më 28 shtator 2014

PO për arkën shëndetësore publike

Në fund të shtatorit do të votohet për Arkën publike Shëndetësore. Unioni i Sindikatave Zvicerane dhe shoqatat e bashkuara në të, ndër të cilat edhe Unia, mbështesin këtë iniciativë popullore. Në vijim do tu shpjegojmë lexuesve tanë përse duhet dhe është kuptimplote të votohet me PO.



Të siguruarit nuk pyten fare për politikën shëndetësore

mbi premitë nuk do të vendosin vetëm anëtarët e bordeve drejtuese apo lobistët e arkave shëndetësore, porse të gjithë.

Sigurimet shëndetësore nuk janë mall!

Që nga 1 janari 1996 të 61 sigurimet shëndetësore të sotme janë të organizuar sipas ekonomisë së tregut (të lirë), ku si pasojë në rend të parë vihet fitimi e jo shëndeti i të siguruarve. Arkat (agjencitë e sigurimeve shëndetësore) sot funksionojnë sipas logjikës të seleksionimit rrezikues, pra mundësisht të siguruar që kushtojnë pak. Kush kushton shumë, mundësisht të mos pranohet fare nga Arkat. Nuk ka fare transparencë dhe – pasi nuk janë të përfaqësuar – të siguruarit nuk kanë pasqyrë, se çka ndodh me premitë e tyre, si dhe s'kanë ndikim politikën e tyre. Kjo tani bëhet vetëm nga anëtarët/ët e bordeve drejtuese dhe shoqatave të tyre të interesit, si fjala bie Santésuisse.

Është i nevojshëm ndryshimi i sistemit

Me Arkën publike shëndetësore zgjidhet përfundimisht problemi i seleksionimit rrezikues, sigurohet një trajtim i njëjtë përfitues, falë ndarjes së rreptë të sigurimit themelor nga ai shtojcë sigurohet transparenca dhe thyhet fuqia e Arkave. Ky ndryshim i sistemit është i nevojshëm për të dhënë fund eksplozimit të premive. Është në të mirë dhe në interes të të siguruarve. Andaj duhet votuar me PO!

➔ Aurora García

Iniciativa popullore «Për një Arkë shëndetësore publike» ka për qëllim që, një Arkë e vetme me agjencitë nëpër Kantone të përbarojë sigurimet themelore shëndetësore. Në

të ardhmen duhet që edhe të siguruarit bashkë me përfaqësuesit e federatës dhe të Kantoneve të jenë të përfaqësuar në organet e kësaj Arke të vetme. Kështu në të ardhmen

Shitje me pakicë, broshura informative

Informata praktike për personelin shitës

«Të drejtat e mija në sektorin e shitjes me pakicë» titullohet broshura e re e sindikatës Unia për personelin shitës. Publikimi trajton situatat shpesh të vështira, me të cilat përballen personeli shitës gjatë rrugëtimit profesional si dhe ofron ndihmë e udhëzime praktike.

Përgjigje në pyetjet më të shpeshta

Njohurit e mbështetura në përvojë të Unia-s janë të pasqyruara në këtë broshurë kompakte dhe praktike. Ajo trajton pyetjet më të shpeshta, ndër të tjera:

- Kontratat e Punës, Administrimi i orëve të tepërta të punës, Puna me porosi, pauzat e detyrueshme dhe vullnetare, e drejta në pushime vjetore, ora e paguar e punës

- Puna gjatë shtatzënisë, pagesa e rrogës në rast të sëmurjes afatgjate, sëmurja e një fëmije, mënyrat e funksionimit të sigurimit të parave ditore në rast sëmundje



- Mbikëqyrja përmes kamerave në vend të punës, kontrolli i gjepave (e çantave) të personelit me rastin e largimit nga vendi i punës, veshmbathja e punës, mungesat e gjësendeve në arka, puna pa dritë ditore, etj.

➔ Aurora García

Ku dhe në cilat gjuhë mund ta gjeni broshurën?

Broshura është botuar në të tri gjuhët vendore. Ajo është në dispozicion në të gjitha 111 Sekretariatet e Unia-s në Zvicër si dhe në tertiaer@unia.ch apo të porositet përmes Telefonit: 031 350 21 11 (ekzemplar në numër të vogël janë falas).

Intervistë



Rita Schiavi

Votimet federale, 30 nëntor 2014

JO Ecopop-it: Mjaft me politikë ksenofobe

Më 30 nëntor 2014 në Zvicër përsëri do të votohet mbi një iniciativë ksenofobe. Iniciativa popullore «Ndal mbipopullimit – për sigurimin e mjeteve natyrore të jetesës» dëshiron të kufizojë emigracionin dhe të nxisë planifikimin familjar vullnetar. Edhe pse pretendohet se, përmes kësaj iniciative dëshirohet të mbrohet ambienti, ajo nuk zgjidh pikërisht këtë problem. Pasi iniciativa nuk vë në pikëpyetje stilin e jetesës së shumicës së popullatës zvicerane (banesat e mëdha, konsumimi i rrymës apo ujit), porse përmend dhe bënë migrantet/ët fajtorët kryesorë për problemet e krijuara në Zvicër nga vetë zviceranët, dhe si e tillë do të detyronte shumë nga ta të punonin me kushte të vështira pune. Mbi këtë iniciativë të rrezikshme kemi zhvilluar një bisedë me Rita Schiavi, anëtare e drejtorisë qendrore të Unia-s dhe njëherazi përgjegjëse për migracionin.

Cilat janë argumentet e Unia-s kundër kësaj iniciative?

Ecopop dëshiron para së gjithash të reduktojë numrin e migrantëve/ëve, të cilët duan të vendosen në Zvicër. Kaluesit e kufirit (nga vendbanimet e shteteve që kufizohen me Zvicrën) dhe ata me leje të shkurtër qëndrimi nuk do të prekeshin nga ky kufizim. Kjo domethënë se, ekonomia nevojën për migrantë do ta mbulonte në kurriz të kushteve të tyre të vështira të qëndrimit, dhe të cilët vendbanimin e rregullt do ta kishin jashtë Zvicrës pa të drejtë të binin familjet e tyre në Zvicër. Ecopop domethënë kthim në gjendjen siç e kishim me statutin punëtorëve sezonal. Pos tjerash aprovimi i Ecopop-it do të paraqiste fund për marrëveshjen bilaterale me BE-në. Ne nuk duam kthim mbrapa në sistemin e Aparteidit, i cili migrantët i shfrytëzon vetëm si fuqi punëtorë!

Cilat do të ishin pasojat me rastin e kalimit të iniciativës?

Për migrantët Ecopop-i paraqet kthim në pasiguri, në kushte të rënda pune, pa të drejtë me jetuar me familje në Zvicër. Apo mbështetur në atë që thoshte Max Frisch: Zvicra donë fuqi punëtorë të jashtëme, mirëpo jo njerëz me nevoja njerëzore! Punëmarrës/e me statut të pasigurt, kjo mund të vërtetohet me të dhëna statistikore, kanë të ardhura më të ulëta. Janë më lehtë për tu shfrytëzuar, pasi varen krejtësisht nga punëdhënësi. Në aspektin ekonomik iniciativa do të kishte ndikim në reduktimin e vendeve të punës në Zvicër si pasojë dhe para së gjithash të vendeve të punës në prodhimtari. Kjo do të godiste para së gjithash migrantet/ët!

Por përfaqësuesit e Ecopop-it përsërisin se nuk janë ksenofob, gjegjësisht se iniciativa nuk është kundër migrantëve?

Vetë iniciatorët ndoshta edhe nuk janë ksenofob, mirëpo ndikimet e iniciativës, pasi që i shkurtojnë të drejtat e migrantëve dhe se migrantët edhe njëherë i paraqesin si të vetmit fajtorë kujdestarë për të gjitha të këqijat e kësaj bote. Iniciativa ndër të tjera dëshiron që të kufizojë lindjet në vendet e varfra. Ky është qëndrim patarnalist dhe kolonialist: në të bardhët e pasur u themi të zinjve të varfër sa fëmijë guxojnë ti kenë ata! Edhe kjo pjesë e iniciativës zbulon qëndrimin e iniciatorëve.

Unia e lufton këtë iniciativë aktivisht, si në kuadër të komitetit votues, ashtu edhe në kuadër të kampanjës së Unia-s kundër Ecopop-it. Angazhohuni edhe ju kundër iniciativës Ecopop. Për më shumë informohuni tek sekretariati i Unia-s në afërsi Tuajën!

➔ Aurora García

Të drejtat e njeriut në botën e punës

A funksionojnë Sindikatat në Kosovë?!

Në shkrimin me titull «Poshtë sindikatat!» gazetarja e Kohës Ditore, Valbona Mehmeti në maj të këtij viti ka publikuar një shkrim mjaft kritik, të cilin për lexuesit e Horizontit po e botojmë të shkurtuar pa ndonjë ndryshim thelbësor.



Pamje nga njëri nga manifestimet me rastin e 1 majit

Pesë muaj pasi ishte martuar, Artës (28 vjeçare), juriste e diplomuar, i kishte skaduar kontrata e punës si promovuese e produkteve të një kompanie private të distribucionit. Me të marrë vesh për martesën dhe shtatzëninë e saj, punëdhënësi i kishte zvarritur ofrimin e kontratës së re njëvjeçare për pesë muaj me arsyetime të ndryshme teknike, si dhe duke i vënë kushtëzime të llojllojshme në punë.

Sa respektohet Kontrata e punës

Para se t'i ofronte kontratën e re, punëdhënësi i kishte shpikur disa vërejtje për shkelje të rregullores së punës dhe të kontratës që Arta nuk e kishte fare.

Kontrata e re i ishte ofruar vetëm për gjashtë muaj dhe ajo i skadonte një muaj para se Arta të shkonte në pushim të lehonisë. Pas skadimit kontrata nuk i ishte vazhduar. Mosvazhdimi ishte arsyetuar nga punëdhënësi me mospërbushjen e detyrave nga e punësuar, mungesën e mjeteve financiare për ta mbajtur në punë dhe me pretendimin se produktet e kompanisë distribuuese do t'i marrë përsipër një kompani tjetër. Fillimisht punëdhënësi kishte tentuar të bënte një lloj pazari me të duke i premtuar se do t'ia marrin motrën në punë derisa ajo të kryejë pushimin e lehonisë. Por as këtë ofertë nuk e kishte realizuar. Një muaj pas largimit nga puna, pozita e saj kishte mbetur vakante dhe në fund, me gjithë «arsyetimet» se nuk mund ta mbajnë në punë për mungesë mje-

tesh financiare, kompania kishte angazhuar një punëtorë të re.

Ligji i të fortit

Punëdhënësi e kishte përgatitur largimin e Artës duke "respektuar" të gjitha normat ligjore dhe duke mos i lënë hapësirë juridike për ankesë. Kur Arta kishte shkuar në Inspektoratin e punës për të shikuar mundësitë e ankesës, aty i kishin thënë se nuk ia vlen as të merret me ndjekjen e së drejtës së saj, sepse do të dilte humbëse. Kompania madje e kishte kërcënuar se nëse ndjek rrugët ligjore për kthim në punë do t'i kërkojnë dëmshpërbim për shpenzimet e gjykatës. Arta tash është e papunë dhe mezi ia del të rrisë foshnjën vetëm me pagën e bashkëshortit.

Raste të tilla si ky i Artës kur gruas shtatzënë i shkelet e drejta e pushimit të lehonisë ka me bollëk në sektorin privat të punës. Duke iu shkelur grave kjo e drejtë, njëkohësisht u shkelet e drejta e fëmijëve të porsalindur për t'u rritur në mirëqenie dhe pa presionin prindëror të mbijetesës sociale.

Mosrespektimi i Ligjit

Ligji i punës parasheh pushim 12-mujor të lehonisë. Gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim 70 për qind të pagës bazë, tre muajt në vijim pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50 për qind të pagës mesatare në Kosovë, ndërsa e punësuar ka të drejtë që ta zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për tre muajt të tjera pa pagesë.

Ligji i punës ndalon shkëputjen e kontratës së të punësuarave shtatzëna apo gjatë kohës kur ato janë në pushim të lehonisë. «Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpusë kontratën të punësuarës dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji», thuhet në nenin 53 të ligjit. Me gjithë të mirat që ka ky ligj, neni 49 për pushimin e lehonisë, praktika po e dëshmon se droja që kishin shfaqur organizatat për mbrojtjen e të drejtave të grave se do të zvogëlojë numrin e grave të punësuar ka qenë e bazuar.

Çalon zbatimi i ligjit

Ligji i punës është ligj i mirë që mbron të drejtën e punëtorit. Por njësoj si ligjet e tjera edhe ky vazhdon të mos zbatohet në praktikë, sidomos në sektorin privat.

Mund të numërohen në gishta kompanitë private në Kosovë që respektojnë plotësisht të drejtat e punëtorëve. Në shumicën prej tyre trajtimi nga punëdhënësi i ngjan epokës së skllavopronarisë; punëtorët mbahen në punë pa kontrata, nuk u respektohet e drejta e pushimit, nuk u ofrohet siguria në vendin e punës, punojnë me orar të stërzgjatur dhe pa kompensim për orët shtesë etj. Si pasojë e papunësisë së madhe, për të ruajtur vendin e punës dhe një rrogë minimale këta punëtorë i durojnë të gjitha shkeljet që bëhen në kurriz të tyre.

Një Maji është dita kur në vendet e zhvilluara festohen vlerat historike dhe arrijtet e organizatave sindikale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve. Është po ashtu dita kur sindikatat ritheksojnë përkushtimin ndaj organizimit të punëtorëve dhe përkrahjes së të drejtave të tyre për paga të dinjitetshme, për mbrojtje sociale, siguri, shëndet dhe vende pune të qëndrueshme.

Por këto vlera universale nuk vlejnë për organizatat sindikale në Kosovë. Sindikatat kosovare thuajse kanë harruar qëllimin e funksionimit të tyre. Udhëheqësit e tyre më shumë se për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, po luftojnë për mbrojtjen e vendit të tyre të punës, pagës së majme që marrin dhe benficioneve të tjera që u jep posti.

Shumica e punëtorëve kosovarë nuk e dinë saktë as kush janë udhëheqësit e tyre sindikalë, as si menaxhohen paratë që ata ndajnë çdo muaj në mbrojtje të drejtave të tyre. Në Ditën Ndërkombëtare të Punës sindikatat e Kosovës as këtë vit nuk patën për çfarë të krenohen. Nëse e konsiderojnë sukses të vetin nënshkrimin e Kontratës kolektive apo rritjen simbolike të pagave, gabohen shumë. Ato nuk janë rezultat i presionit të tyre sindikal, por «vullnet»

i Qeverisë dhe i kryeministrit aktual për të siguruar vota në prag zgjedhjes.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura në Kosovë (BSPK), dikur organizatë që i kundërvihej një regjimi të paskrupullt, sot është kthyer në një institucion të përçarjes dhe flirtit me politikën. Në një vend si Kosova ku papunësia sipas statistikave arrin në 40 për qind dhe ku të drejtat e punëtorëve shkelen në çdo hap BSPK-ja dhe sindikatat e tjera e mbajnë nën kontroll shpërthimin social, duke mos ngritur zërin kundër politikave të Qeverisë dhe duke pranuar «kockën» që ua hedh kohë pas kohe kryeministri Thaçi me disa privilegje dhe me rritje simbolike pagash të shërbyesve civilë.

Në ditën kur edhe në vendet me të drejta më të avancuara të punëtorëve protestohet për kushte më të mira të punës, BSPK-ja nuk lëshon asnjë kumtesë proteste e lëre më të organizojë protesta në rrugë. Madje kreu i saj nuk i sheh protestat si zgjidhje të problemeve sociale.

Duke mos u angazhuar sinqerisht dhe duke minimizuar diskriminimin që u bëhet punëtorëve kosovarë sindikatat po ua mohojnë atyre të drejtën për të kërkuar edhe me protesta ngritje pagash dhe kushte më të mira të punës. Me inercinë e tyre, sindikatat në Kosovë e kanë kthyer Një Majin në një festë shëtitjeje në natyrë të të rinjve të papunë, thuajse krejt punët janë në dyzen.

Sigurimi i kushteve të mira për punë nuk është privilegj, është e drejtë e pamohueshme e punëtorëve. Mbikëqyrja dhe lufta për realizimin e kësaj të drejte nga punëdhënësit është obligim i sindikatave.

Prandaj sindikatat kosovare duhet të dalin sa më shpejt nga kurthi i politikës, sepse kështu si funksionojnë sot më shumë do t'u ndihmonin punëtorëve sikur mos të ekzistonin fare.

© O. Osmani, marrë nga e përditshmja Koha Ditore, valbona@koha.net



Studentët kritikojnë sindikatat e përgjumura



Problemet financiare: mos deklarimi i fitimit të ndërmjetëm?

Unë marrë ka një gjysmë viti para nga Arka e sigurimit të papunësisë dhe përballim me probleme të mëdha financiare. Kërkesat e borxhlinjve shpeshtohen. Tani më është dhënë mundësia të nisi një punë të kufizuar për katër muaj në gastronomi. Nëse unë ketë fitim të ndërmjetëm nuk e deklaroj tek Arka e sigurimit të papunësisë, do të zgjidheshin problemet e mija financiare. Një kolegë ka vepruar ngjashëm dhe më ka thënë edhe mua se Arka e sigurimit të papunësisë edhe ashtu nuk e vëren. A qëndron kjo?

Jo, kjo nuk qëndron fare. Që nga viti 2010 ka hy në fuqi ligji federal për punën në të zehtë (BGSA) dhe edhe Sigurimi i Papunësisë është i obliguar të luftojë keqpërdorimet. Sikur nga paga e puna e juaj të kufizuar, ashtu edhe nga parat kompensimit në rast papunësie, për ju paguhen kontributet në arkën e sigurimit të pension pleqërie (AHV). Sekretariati shtetëror për ekonomi (Seco) krahason kontributet e AHV-së nga Arka e papunësisë dhe të veprimtarisë ekonomike. Nëse vërehen s'përputhje, atëherë Seco lajmëron Arkën e papunësisë. Nëse ju nuk deklaroni vet punën e juaj temporale, të jeni të sigurt se kjo do të zbulohet. Ju do të detyroheni të ktheni parat e marra padrejtësisht dhe varësisht nga shumica do të keni edhe një kallëzim penal në kurriz. Edhe nëse keni arsyet të dukshme, fshehja e punësimit gjatë marrjes së kompensimit nga Arka e papunësisë nuk preferohet në asnjë mënyrë. Kështu ju do ti krijoni vetit probleme edhe më të mëdha.

Michael Schweitzer, work, 3.7.2014

Hyrja anësore: Paga ime prej praktikantit është tejet e ulët. Ku mund të marrë ndihmë?

Unë jam i papunë dhe për shkak të rrethanave të mija profesionale kam vështirësi të gjej një punë. Tani më është dhënë rasti të hyj në rrugë anësore si referent tek një koncern sigurimesh. Problemin qëndron se tani mund të punësohem vetëm si praktikant, pasi që më thonë se unë kam nevojë për një përgatitje të veçantë për ketë punë. Arka e papunësisë nuk pranon rrogën e praktikantit dhe nuk ma paguan kompensimin komplementar shtesë. A ka mundësi ndihme nga ana e Sigurimit të Papunësisë në një rast të tillë?

Po si, ka mundësi. Sigurimi i papunësisë parasheh për raste të tilla kompensim shtesë për integrim në vendin e ri të punës (EAZ). Punëdhënësi juaj është i gatshëm tu paguajë juve rrogën e praktikantit, pasi juve u mungon përvoja në sektorin e sigurimeve dhe nuk mundeni të kontribuoni plotësisht në punë. Fuqia e juaj e punës ende nuk paguhet për ndërmarrjen. Për të motivuar ndërmarrjet që të mundësojnë hyrjen anësore në profesion në kuadër të Sigurimit të Papunësisë është në dispozicion kompensimi shtesë për integrim në vendin e ri të punës. Punëdhënësi juaj ju paguan pagën e zakonshme për vendin dhe sektorin e punës që kryeni. Sigurimi i Papunësisë i paguan një shumë të caktuar firmës që ju ka punësuar për gjashtë muaj rresht për përgatitjen e juaj integruese në vendin e ri të punës. Merrni kontakt me shefin e juaj të ardhshëm dhe informojeni atë mbi kompensimin shtesë. Më së voni deri në dhjetë ditë pasi keni filluar punën e re mundeni ju dhe shefi juaj të bëni kërkesën tek Enti Regjional për Ndërmjetësim Pune (RAV).

Timur Öztürk, work, 30.4.2014

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, D. Filipovic, E. Sariassian, M. Martín, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch